VENDIM
Nr.585, datë 24.8.2011

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME PËRFAQËSUES NË EKIPIN OPERACIONAL TË PATRONAZHIT DHE KOORDINIMIT POLICOR (POMLT) TË VENDEVE TË KARTËS SË ADRIATIKUT, NË OPERACIONIN USHTARAK "ISAF", AFGANISTAN

(Ndryshuar me VKM nr. 164, datë 29.2.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e një përfaqësuesi ushtarak në Ekipin Operacional të Patronazhit dhe Koordinimit Policor (POMLT) të vendeve të Kartës së Adriatikut, të drejtuar nga Kroacia, në kuadër të operacionit ushtarak "ISAF" Afganistan.

2. Autoriteti i drejtimit operacional për përfaqësuesin e Policisë Ushtarake të Forcave të
Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për kohën e qëndrimit në mision, është Komanda Rajonale Qendrore "ISAF" në Kabul, Afganistan.

3. Misioni i përfaqësuesit të Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Ekipin Operacional të Patronazhit dhe Koordinimit Policor (POMLT) të vendeve të Kartës së Adriatikut, të drejtuar nga Kroacia, në kuadër të operacionit ushtarak "ISAF" në Afganistan, është:

a) Marrja në patronazh për trajnimin, drejtimin, mbështetjen dhe zhvillimin operacional të Shkollës së Policisë Ushtarake të Ushtrisë Kombëtare Afgane (SHPUUKA) në Kabul, Afganistan, dhe krijimi i bazave për koordinimin, komandimin/kontrollin dhe kryerjen e planëzimeve në operacion;

b) Pjesëmarrja në kryerjen e operacioneve luftarake dhe mbështetëse për plotësimin e misionit të Shkollës së Policisë Ushtarake të Ushtrisë Kombëtare Afgane (SHPUUKA), në qytetin e Kabulit, rrethinat e tij, si dhe zonën e operacioneve (ZO), e cila mund t'i jepet kësaj shkolle në patronazh nga NATO-ja, me qëllim zhvillimin e një force të aftë, kompetente dhe profesionale për dhënien e kontributit dhe sigurisë së mirëqeverisjes së popullsisë afgane në Kabul apo rrethinat e tij.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni është 2 (dy) vjet, afat, i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të përfaqësuesit ushtarak në Afganistan. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj *së cilës i shtohet edhe periudha e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës*.

5. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për përfaqësuesin ushtarak pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) akomodim, ushqim;

ç) ekologji (pastrim, higjienë);

d) trajtim mjekësor;

dh) ujë të pijshëm;

e) shërbim telefonik celular;

ë) transportimin e individit të shkëputur të misionit për në atdhe, për raste vdekjesh, sëmundjesh dhe thyerje disipline;

f) transport strategjik;

g) shpenzime për trajnimin para dislokimit;

gj) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit;

h) rehabilitim pas misionit.

6. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që do të marrë pjesë në këtë mision.

7. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

8. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha